



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 21, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018 për Marrëdhënie Pune, Zyra Kombëtare e Auditimit, me datën 13.02.2019, publikon këtë:

### **SHPALLJE** **për Angazhim në Punë dhe Detyra Specifike**

- I. Angazhim për shërbime: Dy (2) Përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas**  
**Numri i referencës: PSHS-APDC/ZKA/01-02/19**
- II. Angazhim për shërbime: Një përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas**  
**Numri i referencës: PSHA-APDC/ZKA/02-02/19**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Përkthimi i raporteve të auditimit dhe dokumenteve të tjera në gjuhët e përcaktuara.

#### **Mënyra dhe periudha e angazhimit për shërbime në punë dhe detyra specifike:**

Angazhimi sipas pikës I bëhet me kontratë për punë dhe detyrave specifike për një periudhë të caktuar kohore prej tre (3) muajve, duke filluar nga data 01 prill 2019 deri me datën 30 qershor 2019, kurse angazhimi sipas pikës II bëhet për peridhen nga data 01 mars 2019.

Për shërbimet e kryera, kompensimi bëhet në lartësinë e caktuar me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

#### **Kushtet themelore për angazhimin në punë dhe detyra specifike:**

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte: Diplomë të shkollës së mesme, preferohet fakulteti, së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në fushën e përkthimit në gjuhët përkatëse. Preferohen trajnime në fushën relevante dhe kualifikime tjera profesionale.

#### **Mënyra e konkurimit:**

Kandidatët e interesuar, aplikacionin zyrtar mund ta marrin në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo ta shkarkojnë nga ueb faqja e internetit në adresën: <http://www.zka-rks.org/> dhe mund të paraqesin dokumentacionin në kopje fizike në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën: rr. "Ahmet Krasniqi" nr.210- Prishtinë apo të aplikojnë përmes faqes së internetit në adresën: [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org).

Kandidatët, aplikacionit duhet bashkëngjitur dëshmitë për kualifikimin shkollor, përvojën e punës, dëshmitë për kualifikimet tjera dhe kopjen e letërnjoftimit. Dokumentacioni i pakompletuar me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohet.

Shpallja është e hapur pesë (5) ditë, nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në shtypin ditor me datën 13.02.2019 dhe mbetet e hapur deri më datën 18.02.2019. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin për Burime Njerëzore, në nr.tel. 038/606-004, ext:1005.